



Shtime, 26.09.2023

Nr. 02/ 49

RAPORTI

i dëgjimeve publike për

DRAFT-BUXHETIN 2024-2026

Përgatitja e raportit është bërë duke u bazuar në nenin 9 pika 2 e Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna. Në këtë raport mund të gjeni të dhëna që nga mbajtja e dëgjimit publik dhe mënyra e marrjes së kërkesës nga ana e qytetarëve (formë fizike, elektronike dhe në takimin direkt).

Duke u bazuar në Vendimin e Kuvendit të Komunës së Shtimes, Npi-01/206 të datës 31.05.2023, për të nxjerr në diskutim publik Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024-2026 dhe neneve 14-21 të Statutit të Komunës së Shtimes, 01 R. 006/10911-144, datë 30.04.2014.

Linku në ueb-faqen e komunës:

<https://kk.rks-gov.net/shtime/>

Linku në rrjetin social Facebook:

<https://www.facebook.com/officialKomunaShtime/>

Të gjithë banorët e Shtimes, fshatrave dhe lagjeve, pensionistët, personat me aftësi të kufizuar, përfaqësues të shoqërisë civile si dhe përfaqësues të mediave, janë njoftuar me kohë.

Në këtë dëgjim me publikun për Draft-Buxheti 2024-2026 parashihet evidentimi i kërkesave prioritare që kanë qytetarët e Komunës tonë për ato projekte që ata i cilësojnë si më jetike për të rritur mirëqenien sociale dhe lehtësuar jetën e qytetarëve tanë.

Dëgjimi i parë publik është mbajtur me grupe të Nënperfaqësuar (Gra, të Rinj, Pensionistët, Personat me Aftësi të Kufizuar etj). Ndërsa dëgjimi i dytë publik është organizuar nga KPF-ja në bashkëpunim me Komunën e Shtimes, ku të pranishëm kanë qenë qytetarët e Komunës tonë.

Metodat e konsultimit	Data /Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	F	M	Numri i komenteve, kërkesave, sugjerimeve	Numri i kërkesave të pranuar
Takimi i drejtpërdrejtë me të gjithë qytetarët e komunës së Shtimes të organizuar nga Kryetari i Komunës dhe grupi punues për dëgjimet buxhetore	Nga : 21.09.2023 Deri më 22.09.2023	81	26	55		25

Të gjitha kërkesat e parashtruara në dëgjim publik janë pjesë e raportit.

Vendi i takimit	Data	Ora
Salla e Kuvendit të Komunës	Nga: 21.09.2023 dhe me 22.09.2023	Në ora 14:00

Nr	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për projekt buxhetin e vitit 2024	Statusi i kërkesës /sugjerimi i pranuar ,pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit te komenteve është i detyrueshëm)
1.	Në Mollopolc, të rregullohen gypat në lagjen "Salihaj", pasi që kur ka të reshura të shiut kemi vërshime, si dhe asfalti është i prishur.	Ejup Salihaj	Nuk është pranuar	Nuk ka mjete të futet në buxhet
2.	Planifikimet për kryerjen e punëve në teren, a mbahen në Komunë, që të mund të ngritën shqetësimet nga vetë komuniteti i fshatrave? A mund të ngritët një shqetësim, i cili nuk ka të bëjë me buxhetin komunal, pasi që jam vetë pensionist dhe nga ky Kuvend të ngritet qështja që ka diskriminime në rastet e pensionimit të moshuarve për shkak të pengesave 15 vjeçare ? Të rregullohet rruga "10 Qershori". Tek memoriali në Reçak, duhet të intervenohet dhe të bëhet një muri mbrojtës.	Ahmet Ahmeti	Pjesërisht	Rruga "10 Qershori" është në buxhet. Ndërsa sa i përketë murit mbrojtës, kemi bërë kërkesë nga AMMKM që të investohet.
3.	Për buxhetin e vitit 2024 të ndahet fondi prej 50 mijë eurove për pagesën e Kryetarëve të fshatrave si dhe propozimi i dytë të ndahen 25 mijë euro për funksionin shtesë të komisioneve.	Idajet Rexhepi	Nuk është pranuar	Nuk ka mjete të futet në buxhet
4.	Nuk kemi punëtor teknik tek Shoqata e Pensionistëve dhe pastërtia nuk është në nivel si dhe kemi probleme me parkingun sepse është i vogël. Në fshatin Muzeqinë, rruga tek shkolla është e ngushtë dhe duhet të zgjerohet, po ashtu duhet të ju jepet një vërejtje arsimtarëve për parkimin e veturave të tyre në rrugë.	Ismet Zeqiri	Pjesërisht	Eshtë bërë kërkesë nga drejtoria përkatëse që të hiqen veturat tek pjesa e shkollës
5.	Të rritet numri i zjarrfikësve në komunën e Shtimes.	Skender Dauti	Plotësisht	Eshtë bërë kërkesa për rritjen e numrit të zjarrfikësve
6.	Kërkoj të rregullohet trotuari i papërfunduar përgjatë lumit "Shtimjanja" nga rruga "Afrim Selmanaj" deri tek rruga "Përparim Boshnjaku", si dhe të bëhet ndriçimi publik në këtë hapësirë.	Lulzim Sahiti	Plotësisht	Ky projekt ndërlidhet me projektin e rregullimit të shtratit të lumit. Projekt ky i financuar nga Qeveria.
7.	Lumi Shtimjanja dhe parku në Muzeqinë a janë në projekt buxhet për vitin 2024? Gypat të cilët kalojnë rreth Xhamisë, po krijojnë probleme nëse mund të intervenohet.	Lirim Halimi	Plotësisht	Po, vitin tjetër është në projekt të Drejtorisë të Shërbimeve Publike, me kontratë të mirëmbajtjes.
8.	Trotuari të rregullohet tek shkolla në fshatin Mollopolc. Rruga e "Neredimes", duhet të ketë investime më shumë, të ketë shenjëzim të objekteve që janë përdorur gjatë luftës nga Zona Operative e Nerodimes dhe të vendosen pllaka që do të tregonin se çka ka ndodhur e çfarë është bërë në këtë zonë gjatë luftës së fundit. Po ashtu kërkoj të investohet në Sheshin e Flamurit, i cili ka vlera historike dhe ku mund të shfrytëzohet nga banorët e fshatit për rekreacion.	Brahim Isufaj	Plotësisht	Në kuadër të investimeve tek Sheshi i Flamurit, planifikojmë të aplikojmë tek ministrit gjegjëse për rregullimin e hapsirave publike. Sa i përketë trotuarit, është future në buxhet si emërtim, mirëpo duhet të analizohet vendi se a ka hapsirë për trotuar apo jo.

9.	Rregullimi i ndriçimit tek "Luzhakët", dhe të bëhet trotuari tek lagjia "Hysenaj". Janë disa shtëpi rreth varrezave të cilat janë pa kanalizim, mundësisht të kyçen në rrjedhën e kanalizimit, dikun gjatësia 450 metra.	Agim Hysenaj	Plotësisht	Të gjitha kërkesat janë future në buxhet.
10.	Të rregullohet shtrati i lumit në Godanc. Dy mbrojtëse në fillim të fshatit Godanc tek lumi të rregullohen. Po ashtu edhe një kërkesë për Drejtorin e Urbanizmit, tek rruga "Gashi" është një pjesë e shkurtër që të lidhet me tranzit, nëse ka mundësi të rregullohet.	Qlirimtar Misini	Pjesërisht	Mbrojtëset në fillim të fshatit Godanc do të bëhen. Ndërsa sa i përket rrugës, nuk mund të krijohet qasje të reja në tranzit.
11.	Të rregullohet kanalizimi si dhe të vendoset një dritë në rrugën "Ahmet Shtimja", përkatësisht në hyrje të rrugës që të çon te Salla e Sportit.	Violeta Hysenaj	Pjesërisht	
12.	Kur do të fillojnë procedurat për zhvendosjen e Entit Special në Shtime?	Driton Latifi		

Raporti është përgatitur nga: Gentiana Mehmeti

